

**ZGJEDHJET**

**Kamza, gjerdani i artë i Partisë Demokratike në Shqipëri**



FAQE **2**

**INVESTIMET**

**Kryebashkiaku Mziu inspekton punimet në rrugën "Coca-Cola" dhe "Abdi Bej Toptani"**



FAQE **3**

**NDËRMARRJA E UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE**

**Përpjekje për t'i siguruar çdo qytetari furnizimin me ujë**



FAQE **3**

**MZIU PËR "SUPERSPORT"**

**I angazhuar maksimalisht për të krijuar standardin e duhur për fillimin e kampionatit**



FAQE **8**



Gazetë e Bashkisë Kamzë

# KAMZA

E përdyjavshme  
 Nr. 201 korrik 2017  
 Çmimi 20 lekë  
 drmediakamez@gmail.com  
 www.kamza.gov.al

## Kryebashkiaku Mziu priti në një takim shefin e Zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë, z. Claus Neukirch

FAQE **2**

**Kryebashkiaku Mziu te radio "Nacional": Garantoj çdo qytetar, pavarësisht bindjeve politike, që dera e Bashkisë do të jetë e hapur për këdo**

Faqe 4-5

**Autobusët e rinj në linjën e Paskuqanit, ndikim të jashtëzakonshëm në përmirësimin e transportit urban**

Faqe 3

**Lëvizja Serbe Dveri: Në takimin e Brukselit Vuçiç u pajtua ta njihte shtetin e Kosovës**

Faqe 7

**Fusha e stadiumit të Kamzës, së shpejti gati për ndeshjet e Superligës**

Faqe 8



**2 korrik 1990, një datë, dy ngjarje të mëdha, në Tiranë e në Prishtinë**

FAQE **6**



### NË BRENDËSI

**2 korrik 1990 - 2 korrik 2017: Arratisja, e vetmja alternativë për shqiptarët**

Sot 27 vjet më vonë, shqiptarët janë sërish përballë të njëjtës dhe të vetmes alternativë: të arratisen nga vendi për t'i shpëtuar qeverisë. Sipas një sondazhi ndërkombëtar, rreth 500 mijë shqiptarë të mbetur në Shqipëri duan të ikin nga vendi...

FAQE **6**

**Deklarata Kushtetuese – gurthemel i pavarësisë së Kosovës**

Miratimi i kësaj deklarate ishte pa dyshim një akt me rëndësi vendimtare për historinë më të re të Kosovës e të popullit shqiptar. Ky akt politiko-juridik ishte shprehje e aspiratave të popullit të Kosovës për liri dhe mëvetësi në rrethanat e reja që po krijoheshin asokohe ndër shqiptarët dhe në gjithë rajonin e Ballkanit...

FAQE **7**





## Kryebashkiaku Xhelal Mziu priti në një takim shefin e Zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë, z. Claus Neukirch

**Z. Mziu e vlerësoi shefin e Zyrës së Këshillit të Evropës me titullin “Mirënjohja e Qytetit” me motivacion: “Në shenjë mirënjohjeje dhe nderimi për promovimin e vlerave dhe standardeve në mbështetje të reformave administrative dhe politikave kombëtare, për ndërtimin e kapaciteteve nëpërmjet bashkëpunimit efektiv ndërinstitucional”**

Kryebashkiaku Xhelal Mziu, në takim me shefin e Zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë, z. Claus Neukirch, shpalosi mangësitë e thella që reforma territoriale në përmbajtjen e saj nuk ka përmirësimet ligjore për miradministrim të pushtetit lokal, por ka një përmbajtje shumë të thellë politike. Rasti i Bashkisë Kamëz është rasti unikal i moszbatimit të ligjshmërisë. Qyteti i Kamzës është ndër qytetet më të reja në Shqipëri, por është Bashkia e 5-të për nga numri i objekteve prezente në territor si dhe i 6-ti për nga përbërja e popullsisë. Megjithatë, vështirësitë që paraqet zbatimi i kësaj reforme në kushtet aktuale, politika e lidhshme si menaxhim institucional është mbështetur tek shfrytëzimi i kapaciteteve të Bashkisë si dhe krijimi i një rrjeti të gjerë partneriteti me aktorë të huaj dhe të brendshëm.

Z. Mziu shprehu hapur bashkëpunimin e ngushtë që ka pasur me Këshillin e Evropës, KfW, GIZ, UNDP, USAID, si dhe organizma të tjerë prestigjiozë. Gjithashtu, në këtë takim sqaroi se Bashkia Kamëz është njësi administrative më e vogël për nga territori dhe me një densitet të madh të popullatës. Reforma në përmbajtje pati risi pozitive për rritjen e kompetencave të lidhshme të qeverisjes lokale, por nga ana tjetër ajo ka sjellë fokus negativ. Ndarja administrative e solli Bashkinë Kamëz në aspektin gjeografik si një ishull, ku udhëtimi nga Shkodra bën që të hysh në territorin e Bashkisë Tiranë, më pas në Kamëz, Paskuqan e më pas në Tiranë. Ky është një shembull nonsens ku vërtetohet se reforma ka përmbajtje të thellë politike.

“Në aspektin financiar, kur bëhet përllogaritja për ndarjen e grantit qeveritar, në kohën e qeverisë së PD-së, 75% e këtij granti jepej në fillim të vitit dhe vetëm 25% jepej për projektet. Ndërsa sot 52% e grantit jepet me projekte dhe 48% drejtpërdrejt. Bashkitë e majta për vitet 2015 dhe 2016 kanë marrë 5770 lekë/banorë, ndërsa bashkitë e djathta vetëm 1770 lekë/banorë.

Një banor i Kamzës për vitet 2015 - 2016 ka marrë 33.5 herë grande më pak se një banor i Tiranës. Në 4 vite kemi aplikuar 150 projekte me standarde evropiane dhe 0 lekë të financuara nga kjo qeveri. Janë paraqitur projekte për investime në rrugë, kanalizime, ujësjellës, shkolla, kopshte, çerdhe, gjelbërim etj. dhe asnjë investim për Kamzën. Gjatë kësaj qeverisjeje, në Kamëz është realizuar vetëm rikonstruktimi i qendrës shëndetësore dhe asgjë tjetër. Me ndarjen e re territoriale në vitin 2015, kalimi i kompetencave nga qeverisja qendrore drejt qeverisjes lokale duhej shoqëruar me mjete financiare dhe burime njerëzore, por asnjë kompetencë për Bashkinë Kamëz, përveç kompetencës së stafit mbështetës të sistemit



parashkollor dhe parauniversitar. Janë rreth 1210 km rrugë në inventarin e Bashkisë Kamëz, ku 20 apo 30 km prej tyre mund të trajtohen me statusin e rrugëve nacionale për investim, por 0 investime.

Kemi rreth 244 ha pyje, ku kjo kompetencë për ruajtje dhe mirëmbajtje i kalon Bashkisë Kamëz, por asnjë kompetencë e



deleguar. Po të njëjtën gjë dhe për sistemet e vaditjes e kullimit dhe përsëri kompetencë zero. Konvikti i shkollës “Loro Boriçi” është një institucion që është brenda territorit të Bashkisë Kamëz, por administrohet nga Bashkia Tiranë. Qendra ditore që ka funksion përkujdesjen ndaj moshave të treta, është brenda territorit të Bashkisë Kamëz, por administrohet nga Ministria e Çështjeve Sociale dhe Punësimit. Mbrojtja kundër zjarrit është një kompetencë tjetër e pakaluar ende në varësi të pushtetit vendor. Biznesi i vogël, deri në 5 milionë lekë taksat janë në vartësi të pushtetit lokal, 5 - 8 milionë është fasha që bën ndarjen e trajtimit të taksave, ndërsa mbi 8 milion lekë trajtimi i taksave i kalon qeverisjes qendrore. Kjo ka ndodhur në Kamëz, ku është rritur në mënyrë fiktive xhiroja vjetore e biznesit të vogël, në mënyrë që të përfitojë qeverisja qendrore dhe ndarja e tyre të jetë për interesa të bashkive të majta”, - nënvizoi disa nga kompetencat gjatë bashkëbisedimit kryebashkiaku Mziu.

“Veç të tjerash, Bashkia Kamëz nga taksa e biznesit të vogël ka marrë 118 herë më pak se Bashkia Tiranë dhe 6 herë më pak se Bashkia Vorë. Ky është një tjetër diskriminim që i bëhet Bashkisë Kamëz edhe në këtë drejtim. Në kuadrin e zbatimit të projektit IADSA, Bashkia Kamëz ka qenë e kualifikuar në të gjitha aplikimet e saj në fazën e parë dhe të dytë ku në vlerësimin e këtyre projekteve kanë qenë institucione prestigjioze ndërkombëtare, kur vinte koha e vlerësimit financiar, 0 pikë nga Ministria e Financave dhe kualifikimi të Bashkisë Kamëz dhe vendosja e bashkive që nuk kishin kaluar asnjë nga fazat fillestare. Edhe ky është një tjetër diskriminim që u bëhet qytetarëve të Kamzës, pavarësisht bindjeve të tyre politike. Në të gjitha rastet, u jam drejtuar me shkresë dhe dokumente zyrtare institucioneve përgjegjëse shqiptare si dhe atyre të huaja, ku tregohet qartë diskriminimi i hapur i qytetarëve të Kamzës nga qeverisja qendrore”, - theksoi z. Mziu në mbyllje të bisedës.

Shefi i Zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë, z. Claus Neukirch, e falënderoi z. Mziu për gjithë paraqitjen e situatës reale që ka ndodhur me zbatimin e reformës territoriale në Shqipëri, por në veçanti në territorin e Bashkisë Kamëz, duke vlerësuar se çështjet e ngritura në Kamëz nuk janë trajtuar në asnjë qeverisje lokale ku ai ka pasur takime. “Ky informacion i dhënë nga ana juaj më jep më tepër mundësi në postin që unë mbaj për të paraqitur përpara qeverisjes qendrore nevojën e financimeve pa të cilën misioni i qeverisjes lokale nuk mund të përmbushet”, - u shpreh ai.

Z. Claus Neukirch në fjalën përmbyllëse të tij vlerësoi punën e mrekullueshme të kryer në Bashkinë Kamëz me gjithë pengesat e mëdha që ka pasur në kohë dhe cilësoi se alokimi i fondeve të akredituara për bashkitë nuk duhet të ketë në asnjë mënyrë orientim politik. “Unë mbetem i hapur për të bashkëpunuar fort me z. Mziu”, - e mbylli fjalën e tij. z. Neukirch.

Në fund të takimit, kreu i Bashkisë i akordoi certifikatën “Mirënjohja e Qytetit” shefit të Zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë, z. Claus Neukirch.

## Kamza, gjerdani i artë i Partisë Demokratike në Shqipëri



itorja e thellë dhe e vyer e Partisë Demokratike Kamëz ndaj koalicionit qeveritar e më gjerë vijon traditën e këtij qyteti, i cili edhe këtë radhë zgjodhi vlerat e demokracisë dhe dinjitetit dhe jo ato financiare. Kamza edhe këtë herë injoroi presionin qeveritar, diskriminimin e pushtetit, duke zgjedhur të jetë i lirë në zgjedhjen e vet.

Puna e strukturave politike të PD Kamëz, shoqëruar me investimet dhe shërbimet e Bashkisë bënë që Kamza të jetë gjerdani i artë i Partisë Demokratike në Shqipëri.

Mirënjohje për çdo qytetar për këtë fitore të radhës të Partisë Demokratike Kamëz!





# Kryebashkiaku Xhelal Mziu inspekton punimet në rrugën “Coca-Cola” dhe “Abdi Bej Toptani”

**Investimet, të financuara nga të ardhurat e Bashkisë**



Kryebashkiaku Xhelal Mziu ka inspektuar fazën e punimeve për hedhjen e asfaltit në rrugën “Coca-Cola” në Laknas, me gjatësi 1790 ml. Së shpejti pritet që të përfundojë i gjithë projekti dhe banorët e zonës të kenë tashmë një rrugë me parametra bashkëkohorë. Rruga “Coca-Cola” në Laknas është një nga investimet e rëndësishme të Bashkisë Kamëz. Realizimi i këtij projekti sjell një impakt të jashtëzakonshëm social, si për banorët e zonës, ashtu edhe për ata që zgjedhin të kalojnë në këtë segment rrugor.

Ky investim shtrihet në një zonë problematike në kohën e reshjeve, të cilat shkaktojnë përmytje. Për këtë qëllim,

Bashkia Kamëz ka ndërhyrë me anë të këtij investimi për të krijuar kushte më të mira jetese për qytetarët dhe për zhvillimin e bizneseve. Shqetësimit dhe kërkesave të komunitetit Bashkia Kamëz u është përgjigjur me, me punë, me investime publike dhe shërbime cilësore.

Ndërkaq, kryebashkiaku Mziu ka inspektuar edhe punimet që po kryhen në rrugën “Abdi Bej Toptani”, ku po punohet intensivisht për ndërtimin e saj. Financimi i kësaj rruge është i gjithi nga të ardhurat e Bashkisë.

Rruga ka gjatësi 1400 ml, me gjerësi 10 ml, kunetë 0.5 ml dhe trotuare në të dyja anët e rrugës me nga 2 ml gjerësi. Kjo rrugë do

të kthehet në një segment me parametra bashkëkohorë. Duke pasur parasysh kërkesat dhe nevojat e mijëra qytetarëve të zonës, në prioritetet e Bashkisë Kamëz për vitin 2017 është edhe ndërtimi i kësaj rruge me gjatësi të konsiderueshme dhe që ndikon si në aspektin social ashtu edhe në atë ekonomik.

Kjo, për vetë faktin se realizimi i këtij investimi të rëndësishëm do të ndikojë në shtimin e numrit të bizneseve, duke qenë një nga rrugët kryesore të Kamzës dhe që bën lidhjen e disa lagjeve të këtij qyteti ndërmjet tyre, por edhe me zonat përreth.

## Autobusët e rinj në linjën e Paskuqanit, ndikim të jashtëzakonshëm në përmirësimin e transportit urban



Transportit publik të qytetit të Kamzës i janë shtuar 15 autobusë të rinj, që do të ndikojnë në përmirësimin e ndjeshëm të këtij shërbimi. Kryetari i Bashkisë Kamëz, z. Xhelal Mziu, u shpreh se autobusët e rinj do t'i japin një cilësi tjetër transportit publik në këtë qytet. Bashkia Kamëz së bashku me operatorin e transportit publik, me vënien në punë të këtyre mjeteve kanë bërë që të rritet dukshëm shpejtësia dhe shpeshësia e lëvizjes, ndërkohë që edhe kushtet e shërbimit do të kenë tashmë një cilësi të pakrahasueshme me të kaluarën. Ky është një tjetër premtime i mbajtur i kryebashkiakut Xhelal Mziu i bërë realitet tashmë. Ofrimi i këtij shërbimi me cilësi të lartë vjen pas realizimit të investimit madhor që është drejt përfundimit, rruga “Demokracia”, rikualifikimit urban të bllokut të pallateve në Babrru-Qendër, si dhe rreth 30 projekteve infrastrukturore që po zbatohen aktualisht në Njësinë Administrative të Paskuqanit.

## Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve Kamëz, përpjekje për t'i siguruar çdo qytetari furnizimin me ujë



Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve Kamëz ka intensifikuar punën në terren për të përmbushur detyrat e saj. Me gjithë thatësi të madhe që po karakterizon këtë periudhë, po bëhen të gjitha përpjekjet për t'i siguruar çdo qytetari furnizimin me ujë. Në qendër të vëmendjes është rrjeti i furnizimit me ujë të pijshëm, në të cilin mund të shfaqen defekte të ndryshme, por që me ndërhyrjen e shpejtë të punonjësve të ndërmarrjes janë riparuar në kohë rekord. Ndërkaq, edhe task-forca e Ndërmarrjes së Ujësjellës-Kanalizimeve, e ngritur posaçërisht për këtë periudhë, është këtu ditë në terren, duke verifikuar çdo rast shpërdorimi të ujit të pijshëm. Pas kontrolleve dhe verifikimeve të task-forcës, do të ketë masa me gjorbë, siç e parashikon ligji. Për këtë, ujësjellësi kërkon bashkëpunimin e qytetarëve, si në Kamëz ashtu edhe në Paskuqan. Ndërkohë që Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve është duke i përmirësuar shërbimet, sidomos tani, pas zbatimit të projektit të KfW-së, ajo u bën thirrje atyre që të përdorin me kursim ujin, për shkak të thatësisë së madhe. Në të njëjtën kohë kërkohet mirëkuptimi si i qytetarëve ashtu edhe i subjekteve tregtare për mirëmbajtjen e tërë infrastrukturës së rrjetit të ujësjellësit, që nga pusetat, tubacionet, matësit etj.

## Gjendja Civile në Bashkinë Kamëz, rritje e ritmit të punës së punonjësve

Në zyrat e Gjendjes Civile në Bashkinë Kamëz, këto ditë vihet re një rritje e ritmit të punës së punonjësve që ofrojnë këtë shërbim.

Kjo rritje e punës së Gjendjes Civile vihet re veçanërisht për sa u përket aplikimeve për pasaporta. Shkak për këtë është ardhja e emigrantëve nga vendet e Bashkimit Evropian apo nga vende të tjera.

Duke qenë përballë këtij fakti, zyrat e Gjendjes Civile që ndodhen në Kamëz, në Bathore dhe në Njësinë Administrative të Paskuqanit kanë punuar intensivisht për t'u përgjigjur kërkesave të qytetarëve për shërbimet e kërkuara. Edhe pse është periudhë pushimesh, zyrat e Gjendjes Civile kanë përballuar një fluks të lartë pune, për shkak të emigrantëve që janë paraqitur në sportelet pranë One Stop Shop-it.

Ndërkohë, vihet re edhe një numër i madh i dosjeve për korrigjime të gabimeve materiale në të dhënat e shtetasve. Këto janë gabime, të mbartura me vite të tëra, janë duke u trajtuar rast pas rasti për t'u saktësuar të gjitha të dhënat e shtetasve.

Ndërkaq, vijon edhe puna e përditshme e këtyre zyrave, me dhënie të certifikatave dhe akteve të tjera, si: akte lindjeje, akte lindjeje me jashtë, akte vdekjeje, martesë, bashkime familje, ndarje familjare, shpallje martesë, vendime gjyqate, ndryshim vendbanimi, korrigjime gabimi etj., korrespondencat me drejtori të tjera, komunikimi me zyra të gjendjes civile, prefekturës dhe ambasadave.

Gjithashtu, punonjësit e Gjendjes Civile, përveç sqarimeve të qytetarëve për çdo paqartësi që kanë, janë marrë edhe me firmosje dhe shpërndarje formularësh, pasaportash dhe verifikime të tjera.





## Kryebashkiaku Mziu te radio "Nacional": Garantoj çdo qytetar, pavarësisht bindjeve politike, që dera e Bashkisë do të jetë e hapur për këdo

**Kryetari i Bashkisë Kamëz, z. Xhelal Mziu, ishte i ftuar në radion "Nacional" në emisionin e gazetarit Enea Cenko, për të folur për zhvillimet e fundit politike në vend, zhvillimet në qytetin e Kamzës, investimet, të cilat vazhdojnë gjatë gjithë periudhës, jo vetëm në kohë fushate. Për më tepër, ju ftojmë të lexoni më poshtë intervistën e plotë.**

Do të jem në mënyrë direkte me z. Xhelal Mziu, kryetar i Bashkisë Kamëz, njeriu që bëri të mundur fitoren e thellë të Partisë Demokratike, më saktë fitoren e thellë të elektoratit blu në Kamëz, një nga çelësat e suksesit, afër Tiranës, me një përballje shumë të madhe, normalisht me një presion shumë të madh, duhet theksuar ky fakt. Bëri të mundur një fitore të thellë të Partisë Demokratike, duke gëzuar me disa shpresa elektoratin blu të Shqipërisë.

**Mirëmbërëma z. Mziu!**

Mirëmbërëma dhe faleminderit Enea për ftesën!

**Të falënderoj miku im! Gjithmonë "Nacional Media" është partner i Bashkisë Kamëz.**

Është kënaqësi për mua që të vij tek radio "Nacional"!

**Kënaqësia është jona miku im! Në radhë të parë më duhet të të uroj fitoren! Suksese dhe urime, sepse keni qenë një nga eksponentët e djathtë, që keni bërë të mundur fitoren e thellë të Partisë Demokratike në Kamëz edhe në Paskuqan.**

Nuk është e para herë, janë shtatë fushata elektorale.

**Po kësaj radhe ishte akoma më e thellë, z. Mziu, në një presion të jashtëzakonshëm.**

Shtatë fushata elektorale që unë drejtoj që nga viti 2005 dhe deri në vitin 2017 dhe në të shtatë fushatat ka ardhur në mënyrë progresive rritja e rezultatit të PD-së karshi rivalëve.

**Besoj që kësaj here keni pasur edhe një ego të brendshme për një fitore të thellë.**

Normal që kësaj here kisha edhe një ego personale, për shkak të qeverisë, e cila është hakmarrë në këto katër vite ndaj këtij qyteti, duke mos bërë investime dhe konkludoi me një rezultat bindës të qytetarëve për një votë kundër, pavarësisht që ka ndikuar ndjeshëm presioni qeveritar ndaj votuesve, blerja e votës apo instrumente të tjera shtrënguese që kanë ndodhur ndaj komunitetit të Kamzës.

**Z. Mziu, e kam titulluar këtë intervistë "Çelësi i suksesit për elektoratin blu". Mund të ma thoni sonte se cili është çelësi i suksesit që ju gjithmonë fitoni, mbas shumë presioneve dhe mbas shumë tentativave të ndryshme, mbas shumë e shumë problematikave të ndryshme, ju gjithmonë jeni fitues, z. Mziu.**

Unë kam një çelës vërtet suksesi, një kod që askush nuk mund ta zbulojë, sepse në të gjitha rastet që unë kam bërë fushatë elektorale, kam

qenë i sinqertë në premtime. I kam realizuar ato se çfarë unë kam deklaruar, por ajo çfarë është kryesorja është që unë kam krijuar një partneritet me qytetarët e Kamzës, duke shkuar tek qytetarët nëpërmjet investimeve dhe nëpërmjet shërbimeve ndaj këtyre qytetarëve.

**Z. Mziu, dua t'i përgjigjeni sinqerisht kësaj pyetjeje: Basha ju ka telefonuar për këtë fitore?**

Normalisht që na ka telefonuar.

**Ka qenë një telefonatë e shpejtë apo...?**

Normal, kemi qenë në kontakte gjatë gjithë procesit të numërimit dhe jam falënderuar për rezultatin që arriti Kamza.



**Z. Mziu, "Nacional" përgjatë gjithë këtyre kohëve, përgjatë gjithë këtyre ditëve, menjëherë pas humbjes së thellë të Partisë Demokratike po bën lobing për ju që ju të jeni kryetar i Partisë Demokratike, në emisionet që ne po trajtojmë. Nëse do të ishit ju kryetari i Partisë Demokratike, z. Mziu, çfarë do të bënit më shumë për demokratët?**

Jam i kënaqur aty ku jam aktualisht, sepse kam dy poste, kryetar i Bashkisë dhe kryetar i Partisë. Mendohej në maksimum që t'u shërbej bashkëqytetarëve të mi dhe jam i palëkundshëm në maksimizimin e këtij kontributi, kështu që në këtë aspekt, nuk kam asnjë lloj egoje tjetër, por qëllimi im i parë dhe i vetëm është që unë të maksimalizoj punën dhe shërbimet ndaj këtyre qytetarëve, por duke qenë po prapë një kontribuues për demokracinë dhe për PD-në në vazhdimësi.

**Z. Mziu, nëse do ta shikonit të arsyeshme, cilin emër do të propozonit për kryetar të Partisë Demokratike?**

Unë kam mbështetur dhe vazhdoj të mbështes z. Lulzim Basha dhe unë e vlerësoj maksimalisht lidhshimin e z. Basha në këto katër vite. Unë jam i sigurt që ne duhet të merrnim një rezultat më të mirë sesa ai që morëm, por blerja e votës, paratë e korrupsionit, paratë e drogës jam i sigurt që kanë tjetërsuar votat e qytetarëve. Për të mos qenë dhe aq i orientuar vetëm te kjo pjesë, nuk mund të lë mënjanë pa përmendur edhe një pjesë të demokratëve, të cilët si hatërmbetës, për shkak të mospërfaqësimit të tyre në listën

e deputetëve, jam i sigurt që kanë ndikuar negativisht në pjesëmarrjen në zgjedhje, pse jo, edhe për tjetërsimin e votës.

**Z. Mziu, keni përfunduar me sukses rrugën që lidh Paskuqanin me Kamzën. Them me sukses dhe e kam pritur me shumë dashuri këtë pjesë. Unë kaloj shpesh te ajo rrugë, sepse më lidh shpesh puna me anë të reklamave që ne kemi në Kamëz dhe e kam parë që tashmë për 7-8 minuta, arrin në Kamëz.**

Besoj që është një investim, i cili është kontribut i drejtpërdrejtë i Bashkisë. Është një rrugë prej më shumë sesa 7 km e gjysmë e gjatë. Është një rrugë që i ka kushtuar rreth 3 miliardë lekë buxhetit të Bashkisë. Është e bërë vetëm me taksat e qytetarëve të Kamzës,

trotuaret, ndriçimi, gjelbërimi, stolat apo lulishtet etj., pra do të jetë vërtet një standard që jo vetëm që së ka pasur ndonjëherë Kamza dhe Paskuqani, por nuk e ka as Tirana e asnjë qytet tjetër.

**Është Xhelal Mziu, kryetar i Bashkisë Kamëz. Punon, investon dhe mbi të gjitha është i veçantë, se puna në Bashkinë Kamëz nuk është vetëm në kohë fushate, nuk është vetëm në kohë zgjedhesh, por puna në Bashkinë Kamëz është intensive çdo ditë, çdo minutë, çdo orë dhe kjo meritë e jashtëzakonshme, nën kujdesin e jashtëzakonshëm të z. Xhelal Mziu, kryetar i Bashkisë Kamëz. Z. Mziu, para disa ditësh përruar edhe linjën e re të autobusëve, një tjetër sukses i Bashkisë Kamëz.**

Po, është e vërtetë. Ne kemi disa linja urbane. Kemi bërë një plan të detajuar të linjave urbane të qytetit të Kamzës, duke filluar nga Kamza, nga Bathorja, nga Valiasi, nga Laknasi, nga Frutikultura apo linjat e Paskuqanit, të cilat janë nga Paskuqan 1-shi, Paskuqan 2-shi, nga Kodra e Kuqe apo nga Fushë-Kërçiku dhe Babroji dhe janë linjat më të mira sot për sot në Tiranë dhe Shqipëri, me urbanë të viteve 2010-2012, por edhe një fluks koherent, duke mos lënë më shumë sesa 5 minuta qytetarin për të pritur në stacion. Edhe sistemi i abonesë që fillon në këto ditë, është një tjetër risi ose një tjetër ndihmë që ne u vijmë qytetarëve të Kamzës dhe Paskuqanit për të lëvizur jo vetëm midis qytetit tonë, por edhe me kryeqytetin, Tiranën.

**Do të thotë që ju siguron tashmë edhe një mandat tjetër për Bashkinë Kamëz? Kot nuk kanë thënë që dikur kërkonte Xhelal Mziu të ishte kryetar i Bashkisë Kamëz, sot kërkon Kamza dhe Paskuqani të jesh kryetar i saj.**

Unë kam ambiciet e mia dhe dua të maksimalizoj punën dhe shërbimet ndaj qytetit dhe nuk do të ndalem në këtë drejtim.

**Për t'u rikthyer te Partia Demokratike z. Mziu, a mendon që duhet një tjetër organizim, një organizim më i fuqishëm? Me njerëz më të besuar?**

Unë besoj që data 22 është një moment shumë i mirë reflektimi për të gjithë qëndrestarët e PD-së që kanë kontribuar ndër vite, por edhe prurje të reja, të cilat mund të kontribuojnë, por ajo çfarë është e rëndësishme për mua është që të gjithë ata të cilët kanë përfituar nga PD-ja ndër vite, nuk duhet të shohin interesin e tyre të ngushtë, por duhet të tregojnë dhe duhet të tregojnë veten e tyre në këto zgjedhje, pavarësisht se emri i tyre figuronte apo jo.

**Do të ndalem te një status që kishte bërë z. Murrizi, sepse jeni së bashku me z. Murrizin që po mbron z. Basha, kryetarin aktual të Partisë Demokratike. Myslim Murrizi para disa orëve deklaronte se "erdhët me pizhame dhe tashmë po ikni me supervila nga Partia Demokratike", për këta emra që kishin dalë kundër. Ç'mendim keni?**

Ata që dolën në listë në njëfarë mënyre ranë poshtë nivelit të një përfaqësi politik që ata kishin, sepse zëri i tyre duhet të dëgjohej gjatë 30 ditëve të fushatës, por zëri i tyre u dëgjua,



## INTERVISTA

në fakt, gjatë 30 ditëve të fushatës në mënyrë legale, duke sulmuar kryetarin e PD-së dhe në mënyrë ilegale duke u bërë thirrje qytetarëve për të mos marrë pjesë në votime ose për të tjetërsuar votën.

**Mendoni që Basha do të rikandidojë?**

Jam i bindur që Basha do ta dërgojë deri në fund projektin e Republikës së Re, që Shqipëria të kthehet në blu.

**Ashtu siç u kthye edhe Kavaja. Me këtë rast e përshëndesim edhe kryetarin e ri të Bashkisë së Kavajës!**

Absolutisht, kolegu im, Sakja, besoj që u ka dhënë një tjetër vlerë demokratëve, por edhe qytetit historik të demokracisë, Kavajës, e cila ka qenë dallëndyshja e parë e qyteteve shqiptare.

**Mbasi votoi elektorati, pashë që pjesa më e madhe ishte blu në Kamëz dhe tani e konfirmova që vetëm në Tropojë paska fituar PD-ja, jo në Kukës, me informacionet që pata. Kamza paska fituar goxha thellë.**

Kamza ka fituar, ka shënuar një fitore historike. Ka fituar Tropoja. Ka fituar Hasi. Ka fituar Kavaja. Ka fituar Devolli. Pra, në të gjitha ato qytete në të cilat struktura e PD-së ishte në koherencë të plotë me z. Basha ka fituar. Në disa qytete të tjera, në të cilat qejfmbetësit, si këta firmëtarët e këtyre ditëve, besoj që ka ndikuar në mospjesëmarrjen. Pjesëmarrja shumë e ulët, me 46%, tregon që opozita nuk ka marrë pjesë në votim.

**Demokratët nuk kanë marrë pjesë në votim?**

Po. Dhe mosvajtja e tyre në votim ka pasur influencën e këtyre firmëtarëve, të cilët, jam i sigurt që do të bëhen pjesë aktive e mbajtjes së zgjedhjeve të reja me datë 22 korrik ose do t'u hapin krahun njerëzve të tjerë, të cilëve u dhimbset PD-ja, u dhimbset Shqipëria dhe që duan ta sjellin në pushtet PD-në, sepse, jam i sigurt, që në këto 27 vite, nëse ka lënë dikush gjurmë në investime në Shqipëri; nëse ka lënë dikush gjurmë në integritet, ka pasur vetëm një parti, Partia Demokratike, kështu që besoj që është një apel për çdo demokrat të këtyre 27 viteve që duhet ta lërë mënjanë interesin e tij të ngushtë personal, të bëhet pjesë aktive e zgjedhjeve brenda partisë dhe opozitës, për t'ia shkurtuar ditët kësaj qeverie dhe për të ardhur sa më shpejt në pushtet.

**Z. Mziu, sot Monika Kryemadhi bëri një status goxha të lezetshëm. Uroi për Bashkinë e Kavajës. Më mirë, - tha, - PD-ja sesa dikush tjetër. Mendoni që kanë filluar flirtet me Partinë Demokratike?**

Besoj që Lëvizja Socialiste për Integritet e ka luajtur rolin e saj edhe gjatë qeverisjes. Ndoshta ka pasur mundësinë për t'i shprehur më përpara pakënaqësitë dhe për të mos u bërë palë e mbylljes së këtij mandati nga kjo qeveri. Por unë besoj që më mirë vonë sesa kurrë dhe besoj që edhe pjesa e opozitës së Lëvizjes Socialiste për Integritet do të luajë një rol të jashtëzakonshëm në opozitën dhe në rolin e saj për të shkuar drejt zgjedhjeve të lira dhe jo zgjedhjeve të cilat u imponuan nga droga dhe korrupsioni.

**Mendon që mund të kemi gjendje të parakohshme z. Mziu?**

Absolutisht, ngelem i bindur që kjo qeveri nuk mund ta ketë mandatin e plotë, sepse votat janë tjetërsuar. Unë nuk gjej asnjë argument që të justifikojë një mazhorancë monopartiake pas 27 vitesh, ku në këto katër vite nuk gjej asnjë investim, asnjë premtim të mbajtur, madje edhe në këto katër vite në platformën e kësaj qeverie nuk e di cilat janë premtimet, çfarë do të bëjë. Di vetëm këtë,

që Kryeministri e filloi dhe e mbaroi: Dua që timonin ta përdor unë.

**Përveç timonit, z. Mziu, e di çfarë kishte tjetër, çfarë solli në votë kjo fushatë? Solli bluzën...**

Solli edhe ato rrobat e palestrës.

**Z. Mziu, ku e shikoni të ardhmen e PD-së?**

Normalisht çdo parti lufton për të qenë në qeveri.

**Ndjesë për mosinformacionin, por kandidati që ishte në Kamëz, e mori mandatin?**

Jo, nuk e mori, nuk ishte te pjesa që u kualifikuan, që u morën votat e mjaftueshme, por edhe një herë, do të ishte mirë që të ishim fitues, e meritonim që të ishim fitues. Do të ishte mirë që ne të kishim më shumë deputetë në opozitë, por jam i bindur edhe një herë që opozita që do të zhvillohet, përfaqësimi elitari në Kuvend, platforma e PD-së do të bëjnë maksimumin e mundshëm për të qenë avokatë të qytetarëve të Shqipërisë, pse jo, për të kaluar në zgjedhje të parakohshme.

**Z. Mziu, çfarë kërkoi elektorati në këtë fushatë, sepse ju bëri edhe mirë, për të parë se ku ishte elektorati blu? Jo se ju nuk i takoni, se unë e di se ju i takoni çdo të premtë, por fushata sjell një impakt shumë ndryshe nga ai i takimeve në çdo të premtë.**

Ajo çfarë kërkuan qytetarët në këto ditë fushate kërkoni për të pasur investime.

**Edhe ç'është e vërteta ju keni bërë, z. Mziu...**

Pavarësisht punës që është bërë, në një qytet që është ndërtuar për herë të parë, 21 vite qytet, është qyteti i gjashtë në Shqipëri me më shumë sesa 170 mijë banorë, i mungon akoma infrastruktura dhe ka nevojë për mbështetjen qeveritare, ka nevojë për rrugë, ka nevojë për kopshte, ka nevojë për shkollë, ka nevojë për çerdhe, ka nevojë për ujësjellës, ka nevojë për kanalizime. E mbylli mandatin e parë kjo qeveri dhe pavarësisht që kemi paraqitur më shumë sesa 135 projekte, madje projekte shumë konkurruese, projekte shumë të rëndësishme, projekte shumë sociale, nuk e gjetën asnjëherë zgjidhjen e financimit të tyre nga qeveria vetëm me një motivacion, duke e konsideruar një bastion të djathtë dhe duke mos bërë asnjë financim. Kjo ishte kryesorja. Së dyti, ata kërkoni për të shpëtuar nga gjendja ekonomike ku ata ishin. Kam takuar me dhjetëra dhe me qindra familje, të cilat nuk kishin energji elektrike, sepse nuk kanë mundësi për të paguar; me qindra dhe me mijëra familje, të cilat kanë nevojë për ndihmë ekonomike. Janë me mijëra njerëz që kanë qenë në burg, ose janë në burg, ose janë në gjykatë, ose janë në prokurori, ose janë në polici, dhe ndërkohë që kanë edhe një taksë, taksën "Rama" të energjisë elektrike, që paguajnë 25 mijë lekë në muaj. Madje

ka familje që duhet të rrijë edhe 50 vjet për të shpëtuar nga taksa "Rama", për shkak të energjisë. Por u shtua edhe një barrë tjetër në këto dy javët e fundit, sepse meqenëse impianti i furnizimit me ujë, impianti i Bovillës i cili ndodhet brenda territorit të Bashkisë Kamëz, por që menaxhohet nga Ujësjellësi i Tiranës për të fituar vota ose për të bërë të pakënaqur qytetarët e Kamzës dhe të Paskuqanit, e ndaloi ujin me 50% të kapacitetit të tij dhe kjo solli një revoltë popullore. Një pjesë prej

tyre pakënaqësinë e shprehnin ndaj Bashkisë, por në fakt nuk e kishim ne çelësin e ujit, por e kishte Ujësjellësi i Tiranës dhe kjo është skandaloze, por jam i sigurt që në këto ditë ky impiant nuk do të jetë më pjesë e Ujësjellësit të Tiranës, por do të jetë pjesë e Bashkisë së Kamzës.

**Për të gjithë qytetarët e Kamzës dhe të Paskuqanit, më duhet të kujtoj se besoj që janë qetësuar tashmë, sepse u bë edhe një lajm i famshëm që z. Xhelal Mziu do të prishte ato tarracat, do të prishte ato shtëpitë, në qoftë se do të kishte flamujt e LSI-së dhe të PS-së. U keqinterpretua dhe besoj që për të gjithë ju që keni dëgjuar emisionet tona, avokatin e kemi bërë gjithmonë. Besoj që ju e patë që nuk është prishur asnjë çati.**

Ajo kishte të bënte dhe ka të bëjë vetëm me ndërtimet pa leje, të cilat shpërthyen si kerpudha ditët e fundit, duke pasur si mburojë flamujt e qeverisë aktuale dhe ky ishte sensi i asaj fjale që unë kisha.

**Pra, ndërtimet pa leje, të cilat edhe Kryeministri Rama i ka luftuar?**

I luftoi për katër vite, por i liberalizoi në 20 ditët e fundit, për efekte elektorale.

**Z. Mziu, një përshëndetje për qytetarët e Kamzës dhe Paskuqanit! Është bërë zakon që pas çdo fitoreje z. Mziu vjen te radio "Nacional" për t'i shprehur.**

Ajo çfarë unë do t'u shprehja qytetarëve, edhe një herë, angazhimin tim maksimal për të bërë maksimumin e mundshëm për të gjithë qytetarët, por dua të falënderoj në mënyrë të përzemërt qytetarët e Bathores, të cilët në çdo moment kanë qenë mbështetësit e mi, kanë besuar tek unë dhe më kanë vlerësuar edhe me vota. Dua të falënderoj qytetarët e Valiasit, të Frutikuturës dhe të Laknasit, të cilët kanë kontribuar. Jam i pakënaqur nga qytetarët e Qendër-Kamzës, te të cilët nuk ka ngelur asnjë investim për të bërë. E kam tjetërsuar, nga një zonë e cila ishte absolutisht informale sot nuk i mungon asgjë, po nuk dha votën që i takonte, por edhe qytetarët e Paskuqanit. Janë bërë më shumë sesa 6 miliardë investime, që s'janë bërë në 27 vite, vetëm me buxhetin e Bashkisë, në këta gjashtë muajt e fundit dhe besoj që duhet të ishin pak më koherentë në atë se çfarë kanë marrë, por ngelem i bindur që

Korrik 2017

GAZETA KAMZA



5

edhe ata do të marrin shembullin e qytetarëve të Bathores, të cilat krijojnë një marrëdhënie reciproke midis Bashkisë, PD-së, investimeve dhe jo si një pjesë e këtyre qytetarëve, te të cilët edhe rruga, edhe ujësjellësi, edhe kanalizimi, edhe ndriçimi, edhe gjelbërimi, edhe rivitalizimi kanë vetëm një autor: PD-në, Bashkinë dhe në katër vite ata s'kanë pasur asnjë mbështetje, asnjë qindarkë të financuar nga buxheti i shtetit dhe e tjetërsuan në vota. Jam i sigurt që edhe ata qytetarë, të cilët nuk ishin aq koherentë, do ta kuptojnë vetë në ditët në vazhdim dhe do të bëhen pjesë e mazhorancës në këtë qytet.

**Unë të falënderoj z. Mziu që ishit sonte në radio "Nacional"! Gjithmonë do të kesh mbështetjen e jashtëzakonshme të "Nacional Media Group", sepse ka një audiencë shumë të madhe në Kamëz e Paskuqan, sepse e meriton, sepse je tek të paktët të djathtë, ku normalisht investon të gjitha energjitë e tua për të pasur një Parti Demokratike sa më fituese dhe sa më elektorat blu dhe sa më shumë demokratë, duke e hequr atë zhgënjimin, me ato pak mundësi që ju keni, me ato pak gjëra që ju keni në dorë, sepse unë e di shumë mirë se si është lufta dhe beteja në këto momente që ne flasim dhe nuk e vë fare në dyshim.**

Edhe një herë, unë ndihem shumë i kënaqur që ndodhem në valët e radios "Nacional". Edhe një herë, dua të garantoj bashkëqytetarët e mi të Kamzës dhe të Paskuqanit që nuk punoj për fushatë elektorale. Edhe në këto ditë në vazhdim, pavarësisht temperaturave, do të vazhdojnë investimet, pavarësisht rezultatit. Unë nuk jam si Kryeministri. Kryeministri mori votat, me gjithë koalicionin, bashkë me LSI-në 47% të votave. Por edhe para katër vitesh ka marrë rreth 47 apo 48% të votave, edhe para dy vitesh ka marrë rreth 50% të votave, por nuk kontribuoi me investime në këtë qytet, pavarësisht se kishte rreth 50% të votuesve. E kundërta ndodh me Bashkinë dhe me PD-në. Unë kam bërë investime kryesisht në ato zona të cilat kanë pasur nevojë për investime, pra nuk kam parë lagjet në të cilat unë kam fituar apo lagje në të cilat unë kam humbur. Bie fjala, unë kam humbur në 2015-ën ndjeshëm në Paskuqan 1, kam humbur ndjeshëm në Qendër-Babrru, kam humbur ndjeshëm në Babrru-Shpat apo në Fushë-Kërçik, por më shumë sesa 60 apo 65% e investimeve të Bashkisë ka shkuar fiks në këto zona dhe për të krijuar edhe një herë nevojat, të cilat ata kanë dhe për të mos pasur dallime politike, por edhe i vetëdijshëm që qytetarët, me kalimin e kohës, do të arrijnë që ta kuptojnë partneritetin e Bashkisë, partneritetin e PD-së dhe partneritetin tim, marrëdhëniet me qytetarët pa dallime politike. Edhe një herë, garantoj çdo qytetar, pavarësisht bindjeve të tyre, pavarësisht votës së tyre, që dera e Bashkisë do të jetë e hapur për këdo dhe nevojat e çdo qytetari do të plotësohen, pavarësisht bindjeve të tyre politike apo votës së tyre.

**Z. Mziu, të falënderoj shumë që ishit sonte në "Nacional"! Je gjithmonë mik i "Nacional Media Group" dhe të uroj shumë fort suksese, edhe pse e di që keni një ngarkesë të jashtëzakonshme.**

Faleminderit!





## 2 korrik 1990, një datë, dy ngjarje të mëdha, në Tiranë e në Prishtinë

2 korrikun e 1990-ës dy kryeqytetet shqiptare, Tirana dhe Prishtina, e kanë një ngjarje të shënuar. Vëmendja e Perëndimit dhe botës, si asnjëherë tjetër më parë, u drejtua tek shqiptarët, tek ajo që po ndodhte në Tiranë, kur afro 5000 shqiptarë sfiduan diktaturën e egër komuniste dhe izolimin 45-vjeçar të saj, duke hyrë në ambasadat e vendeve perëndimore dhe, njëkohësisht, në Prishtinë, kur delegatët e atëhershëm të Kuvendit të Kosovës miratuan Deklaratën Kushtetuese të pavarësisë së Kosovës, e njohur si Deklarata e 2 Korrikut.

Në Shqipërinë komuniste, kjo ngjarje, shpërthimi i ambasadave, ishte shpresa për ndryshime të mëdha, për rënien përfundimtare të "Murit të Berlinit" edhe në Shqipëri, muri i fundit i rrëzuar në Evropën komuniste.

Ndërsa në Prishtinë Deklarata Kushtetuese e 2 Korrikut të vitit 1990 ishte akti që do të shënonte hapin historik institucional të pavarësisë së Kosovës, i cili u zhvillua jashtë objektivit të Parlamentit, në kushte të rrethimit nga forca të mëdha policore e ushtarake.

Deklaratën Kushtetuese mbi Kosovën si njësi të pavarur dhe të barabartë në kuadër



të federatës apo konfederatës jugosllave e shpallën në Prishtinë 111 delegatët shqiptarë, po edhe të komuniteteve të tjera të Kuvendit të Kosovës.

Deklarata Kushtetuese e 2 Korrikut shënon edhe pikënisjen për pavarësimin e Kosovës nga Serbia, duke synuar që të trajtohet si e barabartë me republikat e atëhershme

socialiste në federatën jugosllave.

Marrë nga "politiko.al"

## 2 korrik 1990 - 2 korrik 2017: Arratisja, e vetmja alternativë për shqiptarët



Nga Nebil Çika

Sot është përvjetori i 2 korrikut 1990, dita kur shqiptarët masivisht u futën në ambasadat perëndimore në Tiranë, me synimin për t'u arratisur nga vendi në diktaturën komuniste, gjë që konsiderohet si goditja më e madhe që mori pushteti komunist në 45 vjetët e sundimit të tij të egër në Shqipëri. Sot 27 vjet më vonë, shqiptarët janë sërish përballë të njëjtës dhe të vetmes alternativë: të arratisen nga vendi për t'i shpëtuar qeverisë. Sipas një sondazhi ndërkombëtar, rreth 500 mijë shqiptarë të mbetur në Shqipëri duan të ikin nga vendi. Në katër vite të kësaj qeverisjeje 200 mijë të tjerë kanë kërkuar azil në vendet evropiane, ndërkohë që vetëm për lotarinë amerikane në vitin 2017 aplikuan më shumë se 200 mijë të tjerë. Dhe nuk ka si të ndodhë ndryshe. Shqipëria si shtet, qeveri e politikë ka ndryshuar pak apo aspak nga ato

ditë. Ka ndryshuar vetëm forma e regjimit dhe orientimi i formal tij nga Lindja në Perëndim, palët pushteti dhe populli kanë ngelur të pandryshuar. Komunistët ishin atëherë në pushtet, ata apo bijtë e tyre janë sot. Atëherë kontrollonin pronat publike, ekonomi të grabitura në emër të shtetit e pushtetit sot i kanë; jo vetëm që i kanë grabitur, por edhe i kanë privatizuar ato. Nuk ka formalisht burgje, internime e përndjekje politike zyrtare, por ata që përndiqeshin dje me forma të tjera përndiqen edhe sot.

"Agjitacioni e propaganda", neni famëkeq 55, vazhdon të aplikohet me forma të tjera e të sofistikuar, më "demokratike". Nëse je, nëse flet, nëse vepron kundër pushtetit e qeverisë, je automatikisht i penalizuar. Largoresh nga puna nëse je në administratë, sulmohesh nga tatimet dhe organizma të tjerë shtetërorë, nëse ke biznes privat; të pritët asistencë, nëse je i papunë etj. Edhe vrasja është në fuqi, me të vetmin ndryshim me 1990-ën, bëhet pa gjyq, me vrasës me pagesë, me bomba me telekomandë, aksidente rrugore të çuditshme etj. Kemi parë në këto vite vrasje e vdekje enigmatike të politikaneve, bankierëve, biznesmenëve, gazetarëve, të gjitha të pazbardhur e pa autorë.

Oligarkia në pushtet është po ajo e 27 viteve më parë, jo vetëm si linjë e trashëgimi politike, por edhe juridike e gjenetike. Janë të njëjtët emra si atëherë: Hoxha, Koleka, Beqa, Bushati, Gegëprifti, Gjermani, Çuci, Ruçi etj. Nuk ka formalisht zgjedhje të dhunshme njëpartiake, por partia në pushtet i blen e i vjedh në mes të ditës votat që i duhen për të garantuar pushtetin. Drogën dhe trafikun e saj nuk e kultivon e trafikun më shteti si atëherë, por pushteti. Shqipëria vazhdon të jete si atëherë vendi më i varfër e më problematik i Evropës që, si atëherë, vazhdon të bëjë sehir shtypjen e mjerimin e

popullit dhe kombit më të vjetër të saj. Kësaj radhe nuk na ka dhënë çmim ndërkombëtar për ushqimin, por na kanë hequr vizat e përkohshme me vendet Shengen e kanë bërë kandidat për anëtarë në BE. Nuk jemi më anëtare të Traktit të Varshavës, por të NATO-s, por përfaqësuesit tanë atje janë të njëjtët emra, ka ndryshuar për shkaqe natyrale transferimi i pushtetit nga etërit e vdekur apo të plakur te bijtë e rinj e të sofistikuar. Kostumet e rënda e serioze lindore të tyre janë zëvendësuar me xhinse apo kostume moderne mëndafshi, veshjet e firmave më të njohura e më të shtrenjta perëndimore. Udhëtojnë jo me Xhipa rusë e kinezë, por me Mercedesë të prodhimeve të fundit, por nën të janë e ngelen pa ata që i bënë e po i bëjnë gjëmën këtij populli e kombi prej 70 e kusur vjetësh.

E vetmja gjë që ka ndryshuar tërësisht, është qëndrimi i palëve qeveri shqiptare – vende perëndimore për ikjen, arratisjen. Nëse atëherë ishte qeveri shqiptare që nuk të linte të ikje, të vriste në kufi, të arrestonte, të burgoste e të internonte ty dhe familjen vetëm se mendoje të arratiseshe, tani është qeveria ajo që me keqqeverisjen e saj po stimulon arratisjen e sa më shumë shqiptarëve. Tani, ai që mundohet ta ndalojë këtë hemorragji kombëtare është Perëndimi euroatlantik. Ashtu si në 1990 shqiptarët që ia mbërrijnë të shkojnë deri në Gjermani apo vende të tjera të BE-së, mbyllën në kampe refugjatësh dhe shumica dërrmuese e tyre rikthehen me dhunë në Shqipëri. Kjo mund të thuhet se e ka frenuar disi hemorragjinë kombëtare të arratisjes nga vendi, por nuk ka mundur ta heqë atë alternativën, mundësinë e vetme që shumica jonë e sheh si zgjidhje.

Sigurisht që Shqipëria ka edhe ndryshime ekonomike, teknike, politike e shoqërore në këta 27 vjet që nga 2 korriku 1990, por ato

**“ Sigurisht që Shqipëria ka edhe ndryshime ekonomike, teknike, politike e shoqërore në këta 27 vjet që nga 2 korriku 1990, por ato nuk kanë mundur të ndryshojnë thelbin e problemit, faktin që shumica e shqiptarëve duan ende të arratisen nga ky vend. ”**

nuk kanë mundur të ndryshojnë thelbin e problemit, faktin që shumica e shqiptarëve duan ende të arratisen nga ky vend. Ka edhe një pjesë që duan të rrinë, do te thoni ju. Po, sigurisht, edhe atëherë në kushtet kriminale të diktaturës më të egër në Evropë, kishte një pjesë, një pakicë shqiptarësh që nuk donin të iknin, nuk kishin nevojën të arratiseshin si miliona të tjerë, sundimtarët e këtij vendi, gjë që po ndodh edhe sot.

Marrë nga "gazetaminerva.com", 2 korrik 2017





# Deklarata Kushtetuese – gurthemel i pavarësisë së Kosovës



Miratimi i kësaj deklarate ishte pa dyshim një akt me rëndësi vendimtare për historinë më të re të Kosovës e të popullit shqiptar. Ky akt politiko-juridik ishte shprehje e aspiratave të popullit të Kosovës për liri dhe mëvetësi në rrethanat e reja që po krijoheshin asokohe ndër shqiptarët dhe në të gjithë rajonin e Ballkanit. Shuarja e autonomisë po shënonte fillimin e serbizimit të Kosovës dhe në të njëjtën kohë paraqiste hyrje në një periudhë tepër të rëndë për shqiptarët të cilët po trajtoheshin, jo vetëm si qytetarë të rendit të dytë, por edhe po u nënshtroheshin torturave sistematike nga regjimi kriminal serb.

Duke qenë të vetëdijshëm për momentin historik para të cilit ndodhej Kosova, delegatët e atëhershëm të Kuvendit të Kosovës, më 2 korrik të vitit 1990, miratuan publikisht (para Kuvendit të Kosovës) Deklaratën Kushtetuese, me të cilën Kosova u shpall njësi e veçantë në kuadër të federatës së atëhershme jugosllave. Ky ishte një akt historik i prituri moti dhe që shprehte aspiratat shekullore të popullit të Kosovës për mëvetësi shtetërore e territoriale nga Serbia.

Moment politik me rëndësi në ato rrethana ishte fakti se në Kosovë tashmë po vepronte një lëvizje e fuqishme demokratike shtetformuese në krye me LDK-në. Ishte kjo koha kur në horizont tashmë dukej shpërbërja e qartë e ish-RSFJ-së, krijesë kjo artificiale dhe krejtësisht antishqiptare e dominuar kryesisht nga ambicet dhe politika hegjemoniste serbe.

Dy muaj pas shpalljes së Deklaratës Kushtetuese, që në popull njihet edhe si Deklarata e Pavarësisë, pra më 7 shtator të vitit 1990, të njëjtët delegatë nxorën aktin më të lartë juridik - Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me këtë ata edhe formalisht Kosovën e shpallën Republikë.

Por, sikundër pritej edhe në ato momente dramatike, Serbia fill pas shpalljes së Deklaratës Kushtetuese vendosi gjendjen e jashtëzakonshme në Kosovë, duke suprimuar me forcën e tankeve të gjitha institucionet e Kosovës, duke filluar nga Kuvendi e Këshilli Ekzekutiv i tij dhe deri tek të gjitha institucionet e tjera shkencore, arsimore e kulturore.



Nuk ka asnjë dyshim se Deklarata Kushtetuese e 2 korrikut të vitit 1990 shënon pikënisjen e shtetësisë së Kosovës, që do të shpjerë deri në ditët e sotme. Në rrethanat e tashme dhe pas përfundimit të luftës, të masakrimeve, të eksodit masiv të popullit të Kosovës e të shkatërrimeve të tmerrshme, mund të thuhet se ekziston një kontinuitet i fuqishëm i përpjekjeve të popullit të Kosovës për liri, për pavarësi e për shtetësi. Ky kontinuitet nuk mund të mohohet nga askush dhe kjo që po përjeton tash Kosova është meritë e popullit, e atyre që për lirinë e Kosovës u angazhuan politikisht dhe ushtarakisht, e atyre që u sakrifikuan dhe që dhanë jetën për lirinë, për demokracinë dhe për pavarësinë e Kosovës.

Deklarata Kushtetuese e 2 korrikut të vitit 1990 ishte akti që do të shënonte hapin historik institucional të pavarësisë së Kosovës, i cili u zhvillua jashtë objektivit të Parlamentit, por para dyerve të tij, në kushte të rrethimit nga forca të mëdha policore e ushtarake dhe tanke.

## Më poshtë, teksti i plotë i Deklaratës Kushtetuese të 2 korrikut 1990

“Duke u nisur nga vullneti i shprehur vendosmërisht anëmbanë Kosovës nga ana

e shumicës së popullsisë së Kosovës, vullneti ky i sublimuar edhe në Deklaratën e ASHA të Kosovës për pozitë të re kushtetuese të Kosovës, si dhe duke u nisur nga roli dhe pozita e Kuvendit të Kosovës si organ përfaqësues dhe kushtetutëdhënës më i lartë i pushtetit dhe i vetëqeverisjes në Kosovë, Kuvendi i Kosovës solemnisht shpall:

**DEKLARATËN KUSHTETUESE MBI KOSOVËN SI NJËSI TË PAVARUR DHE TË BARABARTË NË KUADËR TË FEDERATËS (KONFEDERATËS) TË JUGOSLLAVISË SI SUBJEKT I BARABARTË ME NJËSITË E TJERA NË FEDERATË (KONFEDERATË).**

1. Me këtë deklaratë shprehet dhe shpallet qëndrimi burimor kushtetues i popullsisë së Kosovës dhe i këtij Kuvendi si akt i vetëvendosjes politike në kuadër të Jugosllavisë.

2. Ky kuvend duke e shpallur nga ana e tij dhe në nivel të tij Kosovën si njësi të barabartë në Jugosllavi, në bazë të principeve të demokracisë autentike mbi respektimin e vullnetit të njerëzve dhe të kolektiviteteve njerëzore dhe kombëtare, pret konfirmimin e këtij akti konstitutiv të tij në Kushtetutën e Jugosllavisë me mbështetje të plotë të

opinionit demokratik në Jugosllavi dhe të opinionit ndërkombëtar.

3. Ky kuvend Kosovën dhe pozitën e re kushtetuese të saj e konfirmon si bashkësi politiko-kushtetuese dhe pozitë politiko-kushtetuese të përbashkët të qytetarëve dhe nacionaliteteve të barabarta të Kosovës, ku shqiptarët si shumicë e popullsisë së Kosovës dhe një ndër popujt më numerikë në Jugosllavi, si dhe serbët dhe të tjerët në Kosovë konsiderohen popull-komb dhe jo kombësi (pakicë kombëtare).

4. Në ndërkohë, deri në aplikimin definitiv juridik të kësaj Deklarate Kushtetuese, Kuvendi dhe organet e pushtetit të Kosovës marrëdhëniet e tyre në rendin kushtetues të Jugosllavisë i mbështesin në Kushtetutën në fuqi të Jugosllavisë dhe jo në amendamentet e Kushtetutës së RS të Serbisë të vitit 1989, me çrast bëhet edhe anulimi i vendimit të Kuvendit të Kosovës i datës 23 mars 1989 mbi dhënien e pëlqimit në këto amendamente.

5. Kuvendi i Kosovës deri në nxjerrjen e Kushtetutës së re të Kosovës tash e tutje do të komunikojë publikisht me këtë emërtim, duke e emërtuar njëkohësisht bashkësinë shoqërore-politike organ i së cilës është, vetëm si Kosovë.

Prishtinë, më 2 korrik 1990. Delegatët nënshkruar të Deklaratës:”

(Pasojnë nënshkrimet e 114 delegatëve shqiptarë, boshnjakë e turq.

Të nesërmen, më 3 korrik, Deklaratën e ka nënshkruar edhe një delegat).

Teksti burimor, i hartuar nga akademiku Gazmend Zajmi, ka pasur edhe pikën 6, me këtë përmbajtje: “Me këtë Deklaratë abrogohet Rezoluta e Këshillit Nacionalçlirimtar të Kosovës e 10 korrikut të vitit 1945 nga Kuvendi i Prizrenit, e cila u nxor në emër të vullnetit të popullsisë së Kosovës, e pa vullnetin e saj”, mirëpo komisionet përkatëse të Kuvendit konsideronin se me vetë miratimin e kësaj Deklarate abrogohej automatikisht edhe Rezoluta e Kuvendit të Prizrenit. Me këtë ndryshim u pajtua edhe autori, tash i ndjeri Gazmend Zajmi.

## Lëvizja Serbe Dveri: Në takimin e Brukselit Vuçiç u pajtua ta njihnte shtetin e Kosovës

Sipas organizatës politike, e quajtur Lëvizja Serbe Dveri, Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiç, ka rënë dakord në takimin me Presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, në Bruksel, që ta njohë shtetin e Kosovës dhe se kjo njohje do të paraprihet nga ndryshimet në Kushtetutën e Serbisë, bënte të ditur kështu “Klan Kosova”. Deklarata e Dverit vazhdon duke shtuar se Partia Përparimtare Serbe dhe ajo Socialiste, këtë po e bëjnë si plotësim të kërkesave që u erdhën nga Brukseli. Sipas Dverit, vetë njoftimi i Vuçiçit për bisedim në nivel presidentësh tregon se ai e konsideron Kosovën shtet dhe se pasuesja e tij në qeverinë e Serbisë, Ana Brnabiç, do ta nënshkruajë njohjen e Kosovës shtet.







## Kryebashkiaku Mziu për "Supersport": I angazhuar maksimalisht për të krijuar standardin e duhur për fillimin e kampionatit



është futur në Superligë nuk do të jetë kalimtare, por do të jetë një skuadër konkurruese. Dhe kjo bëhet vetëm për një qëllim: për t'i kënaqur tifozët e Kamzës dhe për të rritur imazhin e këtij qyteti".

Për sa i përket mbështetjes së ekipit në Superligë, z. Mziu tha: "Normalisht që Superliga ka një tjetër konkurrencë, çfarë do të thotë që do edhe një tjetër infrastrukturë dhe mbështetje financiare.

Ngelem i angazhuar maksimalisht, në bashkëpunim me presidentin e klubit, për të bërë maksimumin në aspektin financiar, por edhe për grumbullimin e lojtarëve të cilët e përligjin konkurrencën e skuadrës. Unë po bashkëpunoj edhe me disa nga bizneset e qytetit, të cilët janë edhe sportdashës dhe që janë të gatshëm për të qenë pjesë e këtij projekti konkurrues të qytetit dhe ndërkohë edhe presidenti, edhe trajneri i ekipit, që nga dita e sotme do të fillojnë edhe përzgjedhjen e lojtarëve të cilët do të jenë pjesë e ekipit".

### Fusha e stadiumit të Kamzës, së shpejti gati për ndeshjet e Superligës

Ka nisur investimi në fushën e stadiumit të Kamzës, e cila do t'i nënshtrohet rikonstruksionit.

Ky është një investim i Bashkisë Kamzë, i cili vjen në kuadër të bashkëpunimit me

Federatën Shqiptare të Futbollit. Pjesë e projektit edhe rikonstruksioni i stadiumit, për sa i përket tribunës qendrore. Ky rikonstruksion përfshin ambientet e brendshme të stadiumit, tribunat, sistemin e ndriçimit, vendet e parkimit të automjeteve apo edhe fasada e jashtme e këtij stadiumi. Punimet që kanë nisur, po ndiqen në mënyrë të veçantë nga kryebashkiaku Xhelal Mziu.

Kreu i Bashkisë ka premtuar se investimet në stadiumin e qytetit do të përfundojnë në kohë, që çdo gjë të jetë gati për ndeshjet e Superligës, ku u ngjit sivjet ekipi i Kamzës, pas një kampionati të shkëlqyer të zhvilluar në Kategorinë e Parë, duke u shpallur kampione e kësaj kategorie.



Kryebashkiaku Xhelal Mziu dha një intervistë për gazetarin Ylli Aga të "Supersport" në lidhje me nisjen e punimeve për rikonstruksionin e stadiumit të qytetit. Kryetari i Bashkisë, z. Mziu, u shpreh optimist për përfundimin e punimeve në prag të fillimit të kampionatit. "Sot po fillojmë zbatimin e një projekti që kemi me Federatën Shqiptare të Futbollit për shtrimin e tapetit dhe gjithë infrastrukturës së fushës për të qenë vërtet një fushë bashkëkohore.

Jo vetëm fusha, por do të plotësojmë edhe standarde të tjera. Jemi të angazhuar maksimalisht për t'i realizuar në kohë shumë të shpejtë sipas standardeve që duhen", - u shpreh ndër të tjera z. Mziu, i cili vijoi më tej: "Jam i bindur se tashmë skuadra që

# BASHKIA KAMËZ



### Informacione

- Sipërfaqe 40.357 km<sup>2</sup>
- Qyteti i gjashtë, 150.000 banorë
- Atraktive për biznesin, mbi 3000
- Mbi 18,000 të punësuar privat
- Mosha mesatare 27 vjeç
- Sistem i plotë adresash
- Rrugë të asfaltuara mbi 200 km
- One Stop Shop modern
- Pallati i Kulturës, Stadiumi etj...

### Kontakte

[www.kamza.gov.al](http://www.kamza.gov.al)

[f bashkiakamez](https://www.facebook.com/bashkiakamez)

[f xhelalmziu](https://www.facebook.com/xhelalmziu)

[xhelalmziu](https://www.instagram.com/xhelalmziu)

### Partneritete

- Bashkimi Europian
- Banka Botërore
- USAID
- KfW
- GIZ
- Macerata, Itali
- Jena, Gjermani
- Galway, Irlandë

Adresa: Bulevardi "BLU" Nr 492 Kamez, tel: +355 47 200 177, e-mail: bashkiakamez@gmail.com, www.kamza.gov.al

Gazeta KAMZA: Drejtor Artan Dervishi; kryeredaktor Behar Hoxhaj, gazetarë: Edmond Duraku, Mina Hysa